



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

01- Nr. 03061-60668 dt. 23/12/ 2024

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në përputhje me nenet 10, 12, 34, 35 dhe 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës së Drenasit, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR THJESHTËZIMIN E SHËRBIMEVE NË KOMUNËN E DRENASIT

1. Me këtë Vendim synohet thjeshtëzimi i shërbimeve të cilat ofrohen nga drejtoritë përkatëse të Komunës së Drenasit.
2. Në të gjitha rastet, kur qytetari bën kërkesë për një shërbim administrativ, për nxjerrjen e të cilit kërkohet një dokument që lëshohet nga e njëjta drejtori apo nga një drejtori tjetër të komunës, zyrtari përkatës i komunës obligohet që dokumentin e tillë të mos e kërkojë nga pala.
3. Nëse dokumenti i lëshuar nga komuna kërkohet si kopje, atëherë zyrtari përkatës kërkon dokumentin për shikim nga pala, dokumenti kopjohet nga ana e zyrtarit dhe vendoset në dosje. Nëse dokumenti i lëshuar nga komuna kërkohet si origjinal, atëherë zyrtari përkatës e nxjerr dhe e vendos në dosje, por nuk e kërkon nga pala.
4. Të gjitha shërbimet administrative për nxjerrjen e të cilave kërkohen dokumente mbështetëse që lëshohet nga e njëjta drejtori apo nga një drejtor tjetër e komunës, janë të paraqitura në Shtojcën 1 të këtij Vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi dhe zbatohet nga data 1 janar 2025.
6. Vendimi u dërgohet të gjithë drejtorive komunale që ofrojnë shërbimet, sipas Shtojcës 1, të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës së Kryeministrit.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Shtojca 1: Shërbimet e thjeshtuara të Komunës së Drenasit

Nr.	EMRI I SHËRBIMIT	EMRI I DOKUMENTAVE QË NUK KËRKOHEM MË PËR MARRJEN E SHËRBIMIT
DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME		
1.	Korigjimi i emrit personal dhe korigjimi i të dhënave të prindërve	1. Certifikata e lindjes 2. Vërtetimi nga arkivi 3. Ekstraktet e lindjes së prindërve
2.	Anulimi i regjistrimit të dyfishtë	1. Kopja e noterizuar e fletëleshimit të spitalit
3.	Regjistrimi i fëmijëve të lindur brenda vendit dhe jashtë vendit	1. Ekstraktet e prindërve
4.	Deklaratë për ushqim	1. Certifikata e lindjes
DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE		
5.	Aplikim për ndarje të subvencioneve për fëmijët e posalindur	1. Certifikata e vendbanimit
6.	Aplikim për banim social	1. Certifikatat e lindjes për anëtarët e familjes 2. Vërtetimi mbi vendbanimin e përhershëm 3. Vërtetimin mbi shkollimin e rregullt
7.	Regjistrimi në skemën e ndihmës sociale	1. Certifikata e Martesës 2. Certifikatat e lindjes (për të gjithë anëtarët e familjes)
DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK		
8.	Aplikimi për ndarje të subvencioneve për Zhvillim Ekonomik	1. Pelqimi sanitar nga Drejtoria e Inspektionit dhe Licenca nga ministria përkatëse e linjës. 2. Certifikata e Biznesit
DREJTORIA E ARSIMIT		
9.	Aplikim për stafin arsimor	1. Certifikata shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësore të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore
10.	Aplikimi për përfitim të bursave studentore	1. Certifikata e vendbanimit 2. Vërtetimi nga fakulteti që nuk është përfitues i bursës univerzitare 3. Trusti

11.	Aplikimi për regjistrim të fëmijës në klasë të parë	1. Certifikata e prindërve 2. Certifikata e vendbanimit
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT		
12.	Aplikim për ndarje të subvencioneve, për kulturë, rini dhe sport (personat fizik)	1. Certifikata e vendbanimit 2. Vërtetimi i tatimit në pronë 3. Dëshmia e pagesës së takses komunale
DREJTORIA E INSPEKSIONIT		
13.	Kërkesa për inspektim	1. Hjeket parashtrimi i kërkesës zyrtare (që nënkupton protokollimin e kërkesës)
14.	Mos kompletimi i lëndës për shqyrtimin e kërkesës, kompletimi bëhet duke komunikuar me drejtortit përkatëse për sigurimin e dokumentacionit	1. Nuk i kërkohet palës kompletimi i lëndës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË		
15.	Kërkesë për dhenjen e lejeve të operimit për Auto-Tax-it	1. Certifikata nga Gjykata Komunale (që nuk është i dënuar/hetime) -orgjinale 2. Certifikata e mjekut me afat validitetit
DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL		
16.	Aplikimi për pagesa direkte (subvencioneve) për bujqësi dhe zhvillim rural	1. Certifikata e tokës 2. Vërtetimi i tatimit në pronë 3. Letërnjoftimi 4. Konfirmimi i xhirollogarisë bankës
17.	Aplikimi për subvencione që ndanë komuna	1. Numri identifikues i fermerit (NIF) 2. Dëshmi për pagesën e tatimit mbi pronën
DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJES TË MJEDISIT		
18.	Leje Mjedisore	1. Kopja e planit 2. Fleta poseduese 3. Vërtetimi i tatimi në pronë
19.	Leja për shfrytëzimin e hapësirave publike	1. Certifikata e biznesit
20.	Certifikata e legalizimit	1. Vërtetimi i tatimit në pronë